

VENDIM
Nr. 144, datë 24.10.2012

PËR FILLIMIN E PROCEDURAVE PËR RISHIKIMIN E RREGULLAVE TË TREGUT SHQIPTAR TË ENERGJISË ELEKTRIKE, MIRATUAR ME VENDIMIN E BORDIT TË KOMISIONERËVE NR. 68, DATË 23.6.2008

Në mbështetje të nenit 8 pika 2 germa “ç” paragrafi “ii”, 9 dhe 54 të ligjit nr. 9072, datë 22.5.2003 “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, nenit 26 të “Rregullave të praktikës dhe procedurave të ERE-s, miratuar me vendimin të Bordit e Komisionerëve të ERE-s nr. 21, datë 18.3.2009, të ndryshuar, Bordi i Komisionerëve të Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 24.10.2012, pasi shqyrtoi relacionin e Drejtorisë Juridike dhe të Mbrojtjes së Konsumatorit dhe Drejtorisë së Licencimit dhe të Monitorimit të Tregut, në lidhje me nisjen e procesit të rishikimit të Rregullave të Tregut Shqiptar të Energjisë Elektrike,

VENDOSI:

1. Fillimin e procedurave për rishikimin e kapitullit X të Rregullave të Tregut Shqiptar të Energjisë Elektrike, miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve nr. 68, datë 23.6.2008.
2. Drejtoria Juridike dhe e Mbrojtjes së Konsumatorit të njoftojë shoqëritë KESH sh.a., OST sh.a. dhe “CEZ shpërndarje” sh.a., për vendimin e Bordit të Komisionerëve.
Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.
Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Sokol Ramadani